

ENTI RREGULLATOR I UJIT



RAPORTI VJETOR

2012

Publikuar nga

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Blv. Gjergj Fishta, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri

E-mail: publik@erru.al
Tel. : 00355 4 2258046
http: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Janar 2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR PËR FURNIZIMIN ME UJË DHE
LARGIMIN E PËRPUNIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA



RAPORTI VJETOR 2012

GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS - KANALIZIME

DHE

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR TË UJIT

Janar, 2013

Përmbajtja

Fjala e Kryetarit	9
1. Autoriteti Rregullator i Ujit	11
1.1 Statusi ligjor dhe përgjegjësitë	11
1.2 Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese e ERRU gjate vitit 2012.....	12
Liçencimi	12
Vendosja e Tarifave.....	13
Aplikimet pilot	16
Monitorimi i sektorit UK.....	16
Rritja e kapaciteteve në sektorin UK	17
1.3 Përfshirja e konsumatorit dhe transparenca gjatë procesit rregullator	17
1.4 Konsolidimi Institucional i ERRU	19
1.5 Bashkëpunimi me Institucione dhe aktorë që veprojnë në sektorin e Ujit	20
Bashkëpunimi me Institucionet në Shqipëri	20
Pjesëmarrje në Aktivitete pune dhe Konferenca Kombëtare	20
Bashkëpunimi me Donatorët e Huaj në Shqipëri.....	21
Bashkëpunimi i ERRU me Institucione Ndërkombëtare	21
Marrëdhëniet e ERRU me Median	22
1.6 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU	22
Të ardhurat.....	22
Shpenzimet operative	23
Realizimi i shpenzimeve	24
2. Gjendja në sektorin Ujësjiellës Kanalizime.....	25
Performanca e shërbimit në sektorin UK	25
Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë.....	25
Uji pa të ardhura	26
Niveli i matjes	26
Norma e arkëtimit	27
Mbulimi i Kostos Operative dhe Kostos Totale.....	27
Pronësia dhe kontrolli i ujësjiellësve	29
3. Këndvështrimi për vitin 2013	30
4. Rekomandime për sektorin UK.....	31

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1	Mbulimi i kostove O & M	14
Grafiku 2	Tendenca e të ardhurave, kostove O&M dhe totale	14
Grafiku 3	Mbulimi i kostos totale.....	15
Grafiku 4	Realizimi i shpenzimeve	24
Grafiku 5	Uji pa të ardhura në %	26
Grafiku 6	Numri i shoqërive sipas normës së arkëtimit	27
Grafiku 7	Mbulimi i kostove me të ardhura	28
Grafiku 8	Struktura e shpenzimeve	28

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Pritshmëritë nga ndryshimi i tarifave dhe synimet për vitin 2013	15
Tabela 2	Të ardhurat	23
Tabela 3	Plani i shpenzimeve	23
Tabela 4	Tendenca e faturimit të matur në vite	27

SHKURTIMET

KKRR	-	Komisioni Kombëtar Rregullator
GIZ	-	Agjensia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
DPUK	-	Drejtoria e Përgjithshme Ujësjiellës Kanalizime
MPPT	-	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MMPAU	-	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
ISHP	-	Instituti i Shëndetit Publik
USAID	-	Agjencia Amerikane për zhvillim Ndërkombëtar
PNUD	-	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
ADA	-	Agjencia Austriake për zhvillim
SHUKALB	-	Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë
ERSAR	-	Autoriteti Rregullator për Ujë dhe Mbeturina (Portugali)
ZRRUK	-	Zyra Rregullatore për Ujësjiellës dhe Kanalizime (Kosovë)
UK	-	Ujësjiellës Kanalizime

Vizioni

Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Misioni

Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë me të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

Fjala e Kryetarit

Viti 2012 ishte një vit tjetër progresi për ERRU në drejtim të një performance gjithnjë në rritje në ushtrimin e funksionit të tij dhe në zbatimin e mandatit dhe misionit rregullator. ERRU vazhdoi me sukses zbatimin e instrumenteve tashmë të përmirësuara rregullatore në dobi të mbështetjes maksimale për shoqëritë UK në mënyrë që këto të fundit të rrisin performancën e tyre të shërbimit ndaj konsumatorit.

Komisioni Kombëtar Rregullator si organ kolegjal dhe drejtues i ERRU-së ka ushtruar funksionin e tij vendimmarrës në zbatim të ligjit 8102. Gjatë vitit 2012, ky komision ka shënuar progres të dukshëm në drejtim të performancës së vendimmarrjeve në mënyrë transparente dhe profesionale duke zhvilluar 33 mbledhje komisioni. Gjatë këtyre mbledhjeve janë marrë 40 vendimmarrje licencash, miratim tarifash, miratim të instrumenteve rregullatore dhe vendime administrative.



Gjatë vitit 2012, ERRU është angazhuar duke bashkëpunuar, koordinuar më intensivisht me aktorët në UK për zhvillimin e standardeve në Sektorin e Ujit. Gjithashtu ka vazhduar bashkëveprimi me operatorët UK duke i këshilluar mbi mundësitë e përmirësimit të performancës, por edhe duke i mbikëqyrur dhe monitoruar që kjo performancë të jetë në dobi të cilësisë së shërbimit të konsumatorit.

Nga 57 shoqëri që ofrojnë një ose disa prej shërbimeve (furnizim me ujë, trajtim të ujit të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura), 50 shoqëri ofrojnë shërbim të licencuar nga ERRU, duke reduktuar kështu gjatë vitit 2012 numrin e shoqërive të palicencuara. Për t'iu përgjigjur dinamizmit të ndryshimeve në sektor, ERRU, gjatë vitit 2012 ndërmoi disa ndryshime lehtësuese në procesin e licencimit dhe po përgatit të marrë një reformë të thellë në fushën e licencimit gjatë vitit 2013.

Për herë të parë në vitin 2012, ERRU publikoi Raportin e Performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime në sektorin UK. Në këtë raport, shqyrtohet performanca individuale e shoqërive dhe e krahasuar me performancën e shoqërive të tjera, për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë të tyre dhe për të parë progresin që ata bëjnë për të përmirësuar shërbimet. Ky raport i jep mundësinë konsumatorëve, që të shohin progresin e arritur në sektorin e ujësjellës kanalizime dhe të vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal.

Gjatë vitit 2012, u aplikuan 9 kërkesa për ndryshim tarife duke zbatuar Metodologjinë e re të Vendosjes së Tarifave. Kërkesat e paraqitura nga shoqëritë kanë respektuar modelet e reja të aplikimit të metodologjisë, të cilat janë një formë e re e paraqitjes së të dhënave dhe përlogaritjes së tarifave. Këto shoqëri ju nënshtruan analizës financiare dhe performancës së tyre si dhe objektivave të vendosur nga KKRR sipas metodologjisë së re.

Nëpërmjet strukturave tarifore të miratuara për secilin operator do të mundësohet rritja e të ardhurave për të arritur së pari objektivin strategjik të qeverisë mbulimin e kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti, si dhe për gjashtë nga operatorët do përballohen dhe interesat e kredisë.

ERRU, në vazhdimësi këmbëngul që mbulimi i kostove nuk duhet të arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përpjekjet sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik nga operatorët. Ulja e humbjeve, rritja e nivelit të faturimit, vendosja e matësve apo rritja e likuiditeteve nëpërmjet përmirësimit të normës së arkëtimit do të jenë objektiva të rëndësishëm të çdo shoqërie dhe do monitorohen nga


ERRU. Operatorët të cilët nuk realizojnë objektivat e performancës të vendosura nga ERRU nuk do t'iu miratohet tarifa sipas propozimit të tyre por sipas analizës së këtyre treguesve.

Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion dhe të dhëna të besueshme si dhe monitorim konstant. Monitorimi jep mundësi që të bëhet një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe të vendosen objektiva sfiduese, por realiste, duke marrë parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive UK. Gjate vitit 2013, ERRU do të bëjë përpjekje maksimale në verifikimin e të dhënave.

Shpreh bindjen time se ky Raport Vjetor do të jetë mjaft i dobishëm si një paraqitje e punës se vazhdueshme të ERRU në përmbushjen e funksioneve rregullatore si dhe një reflektim i situatës së sektorit në tërësi, duke përfshirë dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e politikave dhe qasjeve të nevojshme në këtë sektor.

Së fundmi, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time Komisionit Kombëtar Rregullator, të gjithë stafit të ERRU-së për kontributin e tyre me profesionalizëm dhe përkushtim gjatë këtij viti. Në mënyrë të veçantë do të doja të falënderoja konsulentët e GIZ për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me ERRU edhe për vitin 2012. Si dhe një falënderim i madh i shkon të gjithë donatorëve për kontributin e tyre në sektor dhe veçanërisht në mbështetje të institucionit tonë.

Avni Dervishi



Kryetar i Entit Rregullator të Ujit


1. Autoriteti Rregullator i Ujit

1.1 Statusi ligjor dhe përgjegjësitë

ERRU është institucion publik i pavarur që bën rregullimin e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri, i krijuar me ligjin 8102 dt. 28.03.1996, i ndryshuar, për të siguruar garantimin dhe mbrojtjen e interesave publike dhe për të krijuar një mjedis rregullator transparent. Ushtron funksionet dhe kompetenca e mëposhtme:

- ❖ Licencon persona fizikë apo juridikë, që ofrojnë shërbimin ujësjellës-kanalizime për përfitim publik;
- ❖ Siguron që operatorët t'ju ofrojnë konsumatorëve shërbime me cilësi të mirë dhe efikase dhe me një çmim të arsyeshëm;
- ❖ Përcakton tarifat e shërbimit, në mënyrë që të sigurojmë qëndrueshmërinë financiare të operatorëve si dhe përballimin e tyre nga klientët;
- ❖ Monitoron performancën e operatorëve duke siguruar zbatimin e masave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe duke nxitur progresin e vazhdueshëm të shërbimit, përmes vendosjes së objektivave efikase dhe sfidues;
- ❖ Siguron që operatorët bëjnë më të mirën për klientët dhe mjedisin në vështrim afatgjatë;
- ❖ Analizon ankesat e konsumatorëve dhe i mbështesin ata në zgjidhjen e tyre ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve;
- ❖ Kontribuon me komentet në të gjitha proceset e rëndësishme në sektor si në hartimin e strategjive, politikave dhe legjislacionit kombëtar për sektorin ujësjellës kanalizime;
- ❖ Rregullisht harton dhe vë në dispozicion informacion mbi sektorin ujësjellës kanalizime për të gjithë aktorët në sektor dhe publikun e gjerë p.sh. përmes raporteve Vjetore dhe të Performancës.

Struktura organizative e ERRU është si mëposhtë:



Aktualisht në këto sektorë ERRU ka të punësuar 13 nëpunës dhe 3 punonjës mbështetës.

Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU gjykon se në kuadër të forcimit institucional të këtij Institucioni, përmes reformës së gjithanshme që ka ndërmarrë Qeveria në këtë sektor dhe rolit rregullator në zbatim të kësaj reforme, me synimin për përmbushjen e Misionit dhe Vizionit të tij, rritja e kapaciteteve dhe ndryshimet strukturore janë të domosdoshme. Ndaj në vitin 2011 është paraqitur një kërkesë në Kuvendin e Shqipërisë për ndryshimet në strukturën organizative të ERRU në përshtatje të kushteve të reja dhe shtimit të aktivitetit.

1.2 Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese e ERRU gjatë vitit 2012

Licencimi

Në sektorin ujësjellës kanalizime operojnë gjithsej 57 shoqëri që ofrojnë një ose disa prej shërbimeve (furnizim me ujë, trajtim të ujit të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura). Ecuria e licencimit të shoqërive ujësjellës kanalizime ka ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit duke e çuar numrin e shoqërive të licencuara nga 48 në vitin 2011 në 50 fillim të vitit 2012.

Zhvillimet që pasuan dhe sollën ndryshime në situatën e licencimit të këtij viti ishin të shumta; shumë shoqëri të cilat u licencuan për efekt të përfundimit të afatit aplikuan përsëri brenda një kohe shumë të shkurtër për efekt të ndryshimeve të drejtuesve ligjor / teknik të shoqërive. E njëjta situatë u përsërit dhe me ato shoqëri të cilat kanë operuar me licencë deri në këtë vit. Për këtë arsye KKRR ka miratuar disa ndryshime lehtësuese në Rregulloren e Licencimit për rinovimin e licencës të të gjithë atyre shoqërive të cilat kanë ndryshuar drejtuesit ligjor dhe/ose teknik brenda afatit 4 vjeçar të licencës së dhënë nga ERRU. Nëpërmjet këtyre nismave ERRU synon përmbushjen e një ndër objektivat kryesore për vitin 2013, licencimi i të 57 shoqërive UK.

Gjatë vitit 2012 kanë aplikuar për licencë 28 shoqëri ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit në përputhje me Rregulloren e Licencimit janë licencuar 17 operatorë dhe 11 të tjerë janë në proces. Për herë të parë gjatë këtij viti ka aplikuar dhe është licencuar Ujësjellës Kanalizime sh.a Himarë. Gjithashtu, ju është bërë rinovimi i licencave për efekt të ndryshimeve të drejtuesve ligjorë apo teknike 2 (dy) operatorëve Ujësjellës Kanalizime dhe është bërë rinovimi i licencës për efekt të mbarimit të afatit 14 (katëmbëdhjetë) operatorëve Ujësjellës Kanalizime.

Nga aplikimet e paraqitura për pajisje me licence të subjekteve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura apo vetëm njërën prej këtyre shërbimeve, si dhe disa operatorë UK të cilët nuk kanë aplikuar asnjëherë për tu pajisur me licencë e ushtrimit të veprimtarisë konform ligjit, dinamika e problemeve të licencimit të këtyre subjekteve ka qënë e njëjtë me atë të viteve të mëparshme disa prej të cilave paraqiten në vijim:

- Ndryshimet në periudha shumë të shkurtra brenda një viti të drejtuesve ligjor dhe teknik të shoqërive UK.
- Vështirësitë në gjetjen e drejtuesve teknik, më e theksuar kjo në rastet e operatorëve që veprojnë në zona e vogla urbane me numër të vogël klientësh.
- Shkëputjen e disa njësive të qeverisjes vendore nga zona e mbulimit të shoqërive UK për shkak të investimeve të bëra nga këto vetë këto njësi, si dhe krijimi i sektorëve pranë tyre që operojnë në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura pa marrë një licencë të miratuar nga ERRU.
- Vështirësitë e disa operatorëve UK me kalimin në pronësi të pushteteve vendore, gjithashtu me regjistrimin dhe reflektimin e ndryshimeve të tyre në QKR.

- Problemet financiare për operatorët UK që operojnë në zona të vogla urbane pasi këto shoqëri nuk mbulojnë dot as shpenzimet minimale për të plotësuar kushtet e licencimit.

Vendosja e Tarifave

Gjatë vitit 2012, 9 operatorë aplikuan pranë ERRU për ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve si dhe 1 operator tjetër aplikoi për vendosjen e tarifës fikse për shërbimin e largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura. Të gjitha këto aplikime janë paraqitur në zbatim të “Metodologjisë për vendosjen e tarifave”, miratuar me vendimin të KKRRU nr. 28 datë 28.09.2011, zbatimi i të cilës filloi në vitin 2012. Kërkesat e paraqitura nga shoqëritë kanë respektuar parashikimet e metodologjisë dhe modelit të aplikimit, i cili është një formë e re e paraqitjes së të dhënave dhe përllogaritjes së tarifave.


Objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit, ashtu siç parashikohet në Vizionin dhe Misionin e tij. Vendosja e tarifave sipas kësaj metodologjie përfshin analizën e kostove dhe analizën e performancës, duke i caktuar operatoreve objektiva të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimit. Vlerësimi i propozimit për ndryshimin e tarifave për secilin aplikim është bërë mbi bazën e analizës së situatës aktuale ekonomike financiare dhe treguesve kryesorë të performancës, tendencës së tyre, synimeve të operatorit me tarifat e kërkuara si dhe kushteve specifike të operimit.

Niveli aktual i mbulimit të kostove për shoqëritë që kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave është i ndryshëm, prandaj edhe kostot e marra në konsideratë për vendosjen e tarifave janë të ndryshme. Shoqëri sh.a. UK Fier, Lushnjë, Lezhë, Gjirokastrë dhe Berat-Kuçovë janë operatorë që bëjnë pjesë në Programin Komunal të infrastrukturës të kredituar nga Banka Gjermane për Zhvillim dhe për këtë arsye operojnë nën disa kushte të veçanta. Qëllimi i financimit të këtyre operatorëve është garantimi i një furnizimi të sigurt me ujë të pijshëm “të pastër” për të gjithë konsumatorët si dhe përmirësimi i performancës (rritja e qëndrueshmërisë financiare) të vetë operatorëve. Indikatorët kryesorë për arritjen e këtij qëllimi ndër të tjera janë zvogëlimi i humbjeve teknike dhe mbulimi i kostove. Sipas marrëveshjeve të huasë operatorët duhet të garantojnë kthimin e kredisë. Shlyerja e këtyre kredive si dhe mbulimi i kostove në rritje kërkon sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme. Për këtë arsye arketimi i të ardhurave merr një rëndësi të veçantë. Për të qënë pjesë e investimeve të KFW këta operatorë duhet të arrijnë të mbulojnë me të ardhurat e arkëtuara koston e operimit dhe mirëmbajtjes + koston e kredisë (interesa+ principalin). Përqindja e mbulimit të këtyre kostove është përcaktuar në marrëveshjet respektive.

Tarifat e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura duhet të jenë të përballueshme nga të gjithë konsumatorët. Një rol të rëndësishëm për arritjen e këtij objekti luan struktura e tarifave, ku komponenti “tarifë fikse” mbulon kostot fikse dhe komponenti “tarife variabël” mbulon kostot variabël. Duke patur parasysh që kostot fikse zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale, për të arritur ekuilibrin ndërmjet rritjes së qëndrueshmërisë financiare të operatorit dhe mbrojtjes së konsumatorëve me të ardhura të ulta, fillimisht tarifa fikse do të mbulojë jo më shumë se 30% të shpenzimeve fikse. Aplikimi i kësaj strukture tarifore kërkon që niveli i matjes të jetë i lartë, në veçanti të gjithë konsumatorët jofamiljarë të jenë pajisur me matës dhe sistemi i faturimit të jetë i kompjuterizuar. Aktualisht, operatorët që aplikuan për ndryshimin e tarifave për vitin 2013, me përjashtim të sh.a. UK Pogradec, nuk kanë mundur të plotësojnë këto kushte. Prandaj, struktura e miratuar e tarifave përfshin një “tarifë fikse” për çdo kategori konsumatorësh dhe një “tarifë variabël” për të gjitha blloqet e konsumit.

Nëpërmjet strukturave tarifore të miratuara për secilin operator mundësohet rritja e të ardhurave për të arritur së pari objektivin strategjik të qeverisë mbulimin e kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti. Rezultati i pritshëm nga rritja e tarifave në mbulimin e kostove për vitin 2013 krahasuar me dy vitet e mëparshme për operatorët që aplikuan për ndryshim tarife pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.


Grafiku 1 Mbulimi i kostove O & M



Mbulimi i kostove nuk duhet të arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përpjekjet sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik. Ulja e humbjeve, rritja e nivelit të faturimit, vendosja e matësve apo rritja e likuiditeteve nëpërmjet përmirësimit të normës së arkëtimit varen nga puna e vetë operatorëve. Si rezultat i rritjes së tarifave numri i shoqërive që mbulojnë më shumë se 100% kostos O&M rritet nga një operator në vitin 2012 në katër operatorë në vitin 2013. Për sh.a. UK Lezhë, Rrogozhinë, sh.a. U Përmet dhe Bulqizë si rezultat i rritjes së të ardhurave niveli i mbulimit të kostove rritet rreth 15%.

Nga ndryshimi i tarifave për nëntë operatorët për vitin 2013, të ardhurat në sektor parashikohen të rriten rreth 39% krahasuar me vitin 2012, rritje e cila do të vijë kryesisht nga rritja e tarifave se sa nga niveli i faturimit.


Grafiku 2 Tendenca e të ardhurave, kostove O&M dhe totale



Megjithëse të ardhurat parashikohen të rriten ndjeshëm, operatorët nuk do të arrijnë të mbulojnë koston totale pasi kjo kosto parashikohet të rritet ndjeshëm në vitin 2013. Rritje kjo që vjen për arsye se kostos O&M i shtohen jo vetëm kosto e amortizimit por edhe kosto e

kredisë. Operatorët që kanë marrë kredi për të kryer investime si sh.a. UK Pogradec, Lushnjë, Lezhe, Berat-Kuçovë janë të detyruar të paguajnë jo vetëm interesat e kredisë por edhe këstin e saj. Në vitin 2013, sh.a. UK Gjirokastrë mbetet i vetmi operator që do të mbulojë koston totale.

Grafiku 3 Mbulimi i koston totale



Operatorët duhet të arrijnë objektivat e vendosur nga ERRU për vitin 2013, pasi miratimi i tarifave për periudhën në vazhdim do të jetë i kushtëzuar vetëm për operatorët që arrijnë të përmirësojnë performancën teknike dhe financiare.

Tabela 1 Pritshmëritë nga ndryshimi i tarifave dhe **synimet** për vitin 2013

Sh.a UK Gjirokastrë •Përdorimi i fitimit për: a) reabilitimin e rrjetit ekzistues dhe vendosjen e matësave b) të akumuluar fonde për shlyerjen e kredisë •Përmirësim i TKP • Përmirësimi i shërbimit
Sh.a UK Pogradec; Fier; Berat - Kuçovë; Lushnjë(Qytet) • mbulimi i koston O&M + koston e kredisë (interesat + principalin) • Përmirësim i TKP • Arritja e mbulimit të koston totale
Sh.a UK Lezhë ; Permet • Rritje graduale e të ardhurave nga aktiviteti • Përmirësim i TKP • Arritja e mbulimit të kostove O&M
Sh.a UK Rrogozhinë; Bulqizë •Rritje e nivelit të të ardhurave •Përmirësim i nivelit të mbulimit të kostove O&M • Ulja e nevojës për subvencion

Aplikimet pilot

Sh.a. UK Pogradec dhe Sh.a. UK Fier paraqitën kërkesën për të qenë pilot në implementimin e Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave. Në zbatim të kësaj metodologjie struktura e tarifave për këto shoqëri do të ishte aplikimi i tarifës me dy pjesë, “tarife fikse” dhe “tarife variabël” me blloqe në rritje për konsumatorët me matës.

Për sh.a. UK Pogradec, struktura e miratuar e tarifave përcakton për çdo shërbim dhe për çdo kategori klientësh një tarifë fikse dhe një tarifë variabël me dy blloqe konsumi. Ky operator i plotësoi kushtet për aplikimin e kësaj strukture tarifore për arsye se të gjithë konsumatorët janë të pajisur me matës dhe sistemi i faturimit është i kompjuterizuar. Sipas kësaj strukture tarifave në bllokun e parë të konsumit (deri në 4.5 m³) janë më të ulta se në bllokun e dytë të konsumit (mbi 4.5 m³). Kjo gjë i krijon mundësi konsumatorëve me të ardhura të ulta të kursejnë ujin për të paguar me tarifën më të ulët. Përveç këtyre faktorëve, si eksperience e parë në aplikimin e kësaj metodologjie, vlen për tu theksuar se realizimi i procesit të miratimit të tarifave u bë i mundur si rezultat i bashkëpunimit të mirë ndërmjet operatorit dhe ERRU si për plotësimin e Modelit të Aplikimit dhe dokumentacionit përkatës.

Sh.a. UK Fier plotësoi në mënyrë korrekte dokumentacionin e aplikimit dhe ishte e para shoqëri që realizoi seancën dëgjimore me publikun, por për vitin 2013 operatori nuk mund të aplikojë strukturën e tarifave me shume se një bllok konsumi. Sh.a. UK Fier nuk arriti të përfundonte sipas parashikimit vendosjen e matësave për të gjithë konsumatorët dhe ristrukturimin e bazës së të dhënave në sistemin e faturimit. Për vitin 2013 sh.a. UK Fier do të aplikojë strukturën e tarifave me një bllok konsumi. Eksperienca e deritanishme e implementimit të Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave identifikoi elementet kryesore që duhen plotësuar për zbatimin e saj siç janë: plotësimi i modelit të aplikimit, niveli i matjes dhe sistemi i faturimit.

U vu re se operatorët janë në gjendje të plotësojnë modelin e aplikimit por cilësia dhe saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave do të jetë një nga prioritetet e punës së ERRU. ERRU do të vazhdojë të kërkojë nga operatorët pajisjen me matës të konsumatorëve si një element i rëndësishëm jo vetëm për zbatimin e metodologjisë por edhe i përmirësimit të shërbimit ndaj klientëve. Operatorët duhet të marrin masat e nevojshme për kompjuterizimin e sistemit të faturimit. Në vitin në vazhdim monitorimi i të dhënave, instalimi i matësave dhe zbatimi i tarifave të miratuara do të jenë në fokus të punës së ERRU.

Monitorimi i sektorit UK

ERRU monitoron performancën e operatorëve ujësjellës-kanalizime për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë të tyre dhe për të parë progresin që ata bëjnë për të përmirësuar shërbimet. Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm. Mbrojtja e konsumatorëve për ti siguruar atyre një shërbim cilësor dhe mbrojtja afatgjatë e shërbimeve UK kërkon një njohje më të mirë të sektorit për të marrë vendimet e duhura. Rezultatet e monitorimit të performancës do të përdoren nga ERRU si në procesin e ndryshimit të tarifave edhe gjatë diskutimeve me shoqëritë për identifikimin e mundësive dhe pengesave drejt arritjes së vizionit të ERRU për një sektor ujësjellës kanalizime të pavarur financiarisht i cili ofron shërbime me cilësi të lartë por të përballueshme për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Monitorimi jep mundësi që të bëhet një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe të vendosen objektiva sfiduese, por realiste, duke marrë parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive UK. Arritjet maten sipas Treguesve Kyç të Performancës të cilët janë të njëjtë për të gjithë sektorin, por objektivat e performancës i përshtaten çdo operatori, pasi nëpërmjet tyre kërkohet nxitja e përmirësimeve si për operatorët e dobët, ashtu edhe për ata që kanë

rezultate të mira. Përmbushja e objektivave është thelbësore për operatorët që kërkojnë ndryshim tarifash, pasi atyre u duhet të demonstrojnë një performancë të kënaqshme para miratimit të çfarëdolloj kërkesë për ndryshim tarifash.

Gjate vitit 2012 për herë të parë ERRU publikoi Raportin e performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime ne sektorin UK. Në këtë raport, shqyrtohet performanca individuale e shoqërive dhe e krahasuar me performancën e shoqërive të tjera, duke vënë në dukje si shoqëritë me performancën më të mirë, ashtu edhe ato me performancën më të dobët në vend. Përmes raportit të performancës, vetë operatorët mund të vlerësojnë performancën e tyre duke e krahasuar me atë të operatorëve të tjerë të këtij shërbimi që operojnë në mjedise të ngjashme dhe të dallojnë kështu pikat e tyre të forta dhe të dobëta e të mësojnë nga praktikatat më efikase ose efikase operacionale dhe menaxhuese që përdoren në vende të tjera.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës ka për qëllim dhënien e mundësisë për të gjithë aktorët e interesuar, duke përfshirë edhe vetë konsumatorët, që të shohin progresin e arritur në këtë sektor dhe të vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal duke përbërë kështu një stimul të fuqishëm për përpjekjet e operatorëve për të përmirësuar ofrimin e shërbimit. Publikimi i Raportit të Performancës 2011 është vetëm fillimi i një procesi monitorimi performance të plotë dhe të vazhdueshëm nga rregullatori. ERRU dëshiron të nxisë të gjithë aktorët – shoqëritë, pronarët e tyre, këshillat mbikëqyrës, klientët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë – për tu angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

Rritja e kapaciteteve në sektorin UK

Enti Rregullator i Ujit dhe Shoqata e Ujësjetës Kanalizime me mbështetjen financiare të projektit të Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore në Shqipëri/USAID dhe GIZ në respektim të Strategjisë Kombëtare të Ujit edhe për këtë vit zhvilloi fazën e dytë të trajnimit për anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës të shoqërive ujësjellës kanalizime. Në këtë trajnim morën pjesë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të nëntë shoqërive dhe u zhvilluan në formën e seminareve në dy qytete, përkatësisht Vlora dhe Tirana.

Gjate këtij viti u punua me përditësimin e manualit të trajnimit me zhvillimet me të fundit në sektor. Ky Manual përfaqëson një dokument shumë të rëndësishëm informues dhe referues për të gjithë anëtarët e Këshillave Mbikëqyrës në Shqipëri, në lidhje me rritjen e kapaciteteve dhe përgjegjësi të tyre si monitorues të performancës së shoqërive të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Qëllimi i këtij trajnimi është rritja e kapaciteteve drejtuese në sektorin ujësjellës – kanalizime në lidhje me rolin, detyrat, autoritetin dhe përgjegjësinë e tyre si organi mbikëqyrës i shoqërisë dhe garantimi i mbrojtjes së interesave të aksionareve. Në fund të çdo trajnimi anëtarët e shoqërive të cilët përfundojnë këtë trajnim pajisen me çertifikatë nga Enti Rregullator i Ujit.

1.3 Përfshirja e konsumatorit dhe transparencja gjatë procesit rregullator

Metodologjia e Vendosjes së Tarifave e miratuar në shtator të vitit 2011 nga Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU, filloi zbatimin në praktikë në vitin 2012 për dy operatorë që do të shërbenin si shoqëritë pilot dhe më pas u zbatua në aplikimin për ndryshim tarife të tetë shoqërive të tjera UK.

Një ndër parimet baze të kësaj metodologjie është përballueshmëria, pra vëmendja përqendrohet tek konsumatori si dhe llogaritja e një tarife që ai duhet dhe mund të paguajë për shërbimin që merr. Procesi i llogaritjes së tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura është shumë i rëndësishëm dhe i studiuar me kujdes nga

ERRU. Për këtë arsye Komisioni Kombëtar Rregullator ka sanksionuar në këtë metodologji një element të ri që e rrit transparencën dhe përfshirjen e konsumatorit, seancën dëgjimore.

Metodologjia e vendosjes së tarifave promovon transparencën duke sjelle si risi në procesin e aplikimit për ndryshim tarife, organizimin e një seancës dëgjimore me publikun. Zhvillimi i saj është i detyrueshëm për të gjithë operatorët e mëdhenj dhe rekomandohet dhe për të gjithë operatorët e tjerë. Qëllimi i kësaj seance është komunikimi midis ofruesit të shërbimit dhe konsumatorit, duke i informuar këta të fundit rreth arsyeve për ndryshimin e tarifës si dhe zhvillimeve të mëtejshme të shoqërisë. Gjatë këtyre takimeve operatorët kanë mundësi të shprehin përpara klientëve të tyre arsyet se përse ata kërkojnë ndryshimin e tarifës si dhe të paraqiten projektet dhe investimet që do të realizonin me të ardhurat shtese. Pjesëmarrës në këto seanca janë përfaqësues nga të gjitha kategoritë e klientëve, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe grupe të tjera interesi si dhe përfaqësues të media-ve. ERRU njoftohet për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe i dërgohet një kopje e mendimit të konsumatorëve sipas procesverbalit të mbajtur në takim.

Në kuadër të reformave të vazhdueshme në sektorin e ujit dhe i fokusuar ndaj çështjeve të konsumatorit, ERRU në bashkëpunim me PNUD ndërmorën një studim me temë “Perceptimi i qytetarëve mbi cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”. Qëllimi i këtij studimi ishte të ofrojë të dhëna lidhur me perceptimet e qytetarëve mbi cilësinë e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Këto të dhëna do të përdoren si nga ERRU për të monitoruar cilësinë e shërbimit që u ofrohet konsumatorëve, por edhe nga palë të tjera interesi. Gjithashtu ky studim është i vlefshëm edhe për ofruesit e shërbimeve në mënyrë që ata të përcaktojnë objektivat duke monitoruar veten dhe perceptimin e klientëve të tyre lidhur me cilësinë e shërbimeve që ato ofrojnë.

Ky studim u krye në 10 operatorë në zona të ndryshme të Shqipërisë: Shkodër, Mirdite, Lezhë, Tiranë, Durrës, Pogradec, Vlorë, Sarandë, Tepelenë dhe Elbasan (fshat) dhe u përfshinë të tre kategoritë e konsumatorëve: familjare, biznese dhe institucione publike. Ndër çështjet që u morën në shqyrtim mund të përmendim aksesin në shërbim dhe përdorimi, cilësia e shërbimit, pagesat dhe transparenca si dhe ndërveprimi dhe komunikimi i shoqërive me konsumatorët. Rezultatet e studimit janë analizuar me qëllim për të ofruar një sërë rekomandimesh që synojnë përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve nga shoqëritë përkatëse.

Një tjetër moment i rëndësishëm në punën e ERRU për vitin 2012 ishte publikimi për herë të parë i Raportit të Performancës së shoqërive që operojnë në sektorin ujësjellës kanalizime. Ky raport erdhi jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe si një nismë e re e monitorimit dhe benchmarking të shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe/ose largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në Shqipëri. Duke bërë publik këtë informacion të detajuar për publikun e gjerë lidhur me performancën e secilës prej 56 shoqërive ujësjellës kanalizime, ERRU vazhdon përpjekjet për rritjen e transparencës në sektor.

Raporti i Performancës solli rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm të 56 shoqërive ujësjellës kanalizime mbi bazën e 10 treguesve kryesore të performancës (TKP). Nëpërmjet konkluzioneve të këtij raporti, shoqëritë kanë mundësi të kuptojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe të mësojnë nga shoqëritë e suksesshme dhe praktikat e mira të menaxhimit, ndërsa konsumatorët të shohin dhe të vlerësojnë se si performon shoqëria që i ofron shërbimet ujësjellës kanalizime në vite dhe në raport me shoqëri të tjera në vend.

Në thelb paraqitja e informacionit mbi sektorin ujësjellës kanalizime për të gjithë palët e interesuara, përfshirë këtu dhe publikun e gjerë, është pjesë e qëllimit të Entit Rregullator të Ujit për të patur një sektor të orientuar drejt kërkesës së konsumatorëve që zhvillohet në mënyrë transparente.

Si pjesë e punës së ERRU është edhe monitorimi i zbatimit të kushteve të licencës, monitorimi i tarifave të miratuara si dhe standardeve të tjera të me te cilat shoqëritë ujësjellës kanalizime duhet te operojnë ne sektor. Kontrata model dhe implementimi i saj ka qenë në fokus të punës për vitin 2012. Një grup pune i ngritur për monitorimin e implementimit të kontratës model ka operuar me mbledhjen e informacionit nga shoqëritë ujësjellës kanalizime për të paraqitur një situatë me të qartë rreth zbatimit të kontratës model për secilën shoqëri në veçanti dhe për të gjithë shoqëritë në total.

Megjithëse mjaft shoqëri kanë ecur me ritme të kënaqshme e disa prej tyre e kane përfunduar procesin e lidhjes se kontratës model me të gjithë klientët, mbetet ende punë për tu bërë. Objektivat e vendosura nga ERRU mbi implementimin e kontratës model për të gjithë konsumatorët publik dhe privat deri në fund të vitit 2011 ende nuk janë arritur. Nga raportimet e marra rezulton se 68% e klientëve publik dhe 29% e klientëve privatë tashme kane lidhur kontratën e re. Situata paraqitet jo e kënaqshme për kategorinë e klientëve familjar të cilët përbëjnë edhe pjesën më të madhe në numrin total të klientëve të çdo shoqërie, ku vetëm 16.5% e tyre janë pajisur me kontratën model në të gjithë vendin. Përqindja e zbatimit te kontratës model ne shkalle vendi për te gjithë klientët është 17.8%.

ERRU do të vazhdojë të mbikëqyrë dhe monitorojë këtë proces derisa të gjithë klientët në sektorin UK do të lidhin kontratën model duke rregulluar kështu marrëdhëniet me shoqërinë që ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në bazë të kushteve të kontratës së miratuar nga KKRR. Gjithashtu ERRU do të inkurajojë dhe do të nxisë të gjitha shoqëritë UK në vend që ta finalizojnë sa më parë të jetë e mundur këtë proces, i cili vendos një standard te rëndësishëm në marrëdhënien shoqëri – klient në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Pjesë e synimit të ERRU për më shumë transparencë në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime në Shqipëri, është faqja re e internetit, e zhvilluar me mbështetjen e GIZ, e cila ofron një gamë të gjerë informacioni në të gjithë aspektet e funksioneve dhe aktiviteteve rregullatore, në shqip dhe anglisht. Aktorët në sektor, duke përfshirë operatorët dhe publikun e interesuar, kanë tashmë akses në të gjitha metodologjitë dhe dokumentat përkatëse, dhe mund të informohen mbi punën aktuale duke përfshirë edhe statusin dhe vendimet përfundimtare lidhur me licencimin dhe ndryshimin e tarifave, ose mund të shkarkojnë publikimet e ERRU siç janë raportet vjetore dhe të performancës. Faqja e re e internetit është gjithashtu një mjet për të arritur më mirë tek konsumatorët, të cilët ftohen të lexojnë mbi ndryshimet që ka bërë ERRU, mekanizmin për të përfshirë përdoruesit e shërbimit në procesin rregullator dhe se si mund të arkivohen ankesat e pazgjidhura. Të gjithë vendimet e rëndësishme, njoftimet dhe zhvillimet do të publikohen online.

1.4 Konsolidimi Institucional i ERRU

Në përputhje me ligjin 8102 si dhe në përmbushje të objektivit të përcaktuar nga Strategjia Kombëtare Sektoriale për shërbime ujësjellës kanalizime edhe për vitin 2012, ERRU ka pasur në fokus të punës konsolidimin institucional të tij për të ushtruar plotësisht rolin dhe përgjegjësitë në sektorin e ujit. Forcimi i mëtejshëm institucional përmes bashkëpunimit me aktorë kryesor në sektor, rritjes se kapaciteteve duke rritur në mënyrë sasiore dhe cilësore trajnimet, kualifikimet dhe angazhimet në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ka synuar në përmirësimin e zbatimit të mandatit rregullator, sigurimin dhe garantimin e mëtejshëm të mbrojtjes së interesave publike, nxitjes për rritjen e efikasitetit se shoqërive UK dhe sigurimin e një mjedisi rregullator transparent. Shtyllat kryesore ku ERRU ka bazuar konsolidimin e tij institucional kanë qenë:

- Aplikimi i metodologjisë së re të vendosjes se tarifave ne mënyrë profesionale për t'iu garantuar konsumatorëve shqiptarë shërbime cilësore, efikente dhe me çmim të drejtë .

- Publikimi i Raportit të parë të Performancës të ERRU- së nëpërmjet të cilit është monitoruar performanca e operatorëve ujësjellës-kanalizime për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë të tyre dhe për të parë progresin që ata bëjnë për të përmirësuar shërbimet.
- Ndërmarrja e disa studimeve dhe analizave të cilat konkludojnë në standarde për përmirësimin e shërbimit në sektor.
- Hartimi i Kodit të Integritetit të ERRU-së për përmbushjen me sukses të detyrave institucionale e ligjore, me qëllim që vendimmarrja të jetë e drejtë dhe e bazuar në të mirën e publikut.
- Përmirësimi i plotë i faqes zyrtare të ERRU-së për të rritur transparencën dhe për të mbajtur publikun gjithmonë të informuar.

1.5 Bashkëpunimi me Institucione dhe aktorë që veprojnë në sektorin e Ujit

Bashkëpunimi me Institucionet në Shqipëri

Enti Rregullator i Ujit ka një bashkëpunim të suksesshëm me një numër të madh partnerësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Bashkëpunimi i ngushtë vazhdon me një sërë institucionesh qendrore dhe aktorësh si brenda sektorit ashtu edhe jashtë tij me synimin kryesor efektivitetin e shërbimeve ujësjellës kanalizime. Për vitin 2012 ky bashkëpunim ka vijuar me:

- Kuvendin e Shqipërisë
- Këshillin e Ministrave
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT)
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave(MMPAU)
- Autoritetin e Konkurrencës
- Institutin e Shëndetit Publik (ISHP)
- Shoqatën e Ujësllës Kanalizimeve të Shqipërisë (SHUKALB)

Pjesëmarrje në Aktivitete pune dhe Konferenca Kombëtare

❖ *Aktivitete të organizuara nga ERRU*

- Workshop ku u prezantua për herë të parë i Raportit të Performancës të gjithë aktorëve, donatorëve, shoqërive UK dhe publikut të gjerë mbi performancën e çdo shoqërie UK.
- Workshope për trajnimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, faza e dytë e trajnimeve.
- Workshopi për prezantimin dhe diskutimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të dy studimeve të ndërmarra nga ERRU "Perceptimi i qytetarëve mbi cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime" si dhe "Qasja e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në zonat informale urbane dhe në zonat rurale në 5 rrethe të Shqipërisë".

❖ *Pjesëmarrja e ERRU-së në aktivitetet e Sektorit UK*

- Kontributi i ERRU-së si një aktor i rëndësishëm rregullator në sektorin UK ka qenë i vlefshëm në aktivitetet e zhvilluara nga MPPT duke marrë pjesë në grupe pune për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale, në Grupin Këshillimor për konsultimin e Dokumentit Strategjik Sektorial për sektorin apo udhëzime për menaxhimin e shoqërive ujësjellës-kanalizimeve
- Në kuadër të zhvillimeve në institucione qendrore në sektorin e Ujit, ERRU ka kontribuar gjithashtu me komente dhe sugjerime për Menaxhim të Integruar të Burimeve Ujore në Shqipëri, për Standardet Teknike të Sektorit UK etj.
- Në Konferencën Kombëtare të Ujit që u zhvillua nga SHUKALB në muajin nëntor të këtij viti ERRU, pati role mjaft aktive dhe të rëndësishme prezantimi dhe moderimi në disa sesione ku në qendër të diskutimit ishte konsumatori dhe rëndësia e ujit në ditët e sotme.

Bashkëpunimi me Donatorët e Huaj në Shqipëri

- ❖ *Bashkëpunimi me Qeverinë Gjermane* përmes projektit të financuar nga **GIZ** duke kontribuar në disa proçese rregullatore me objektivin kryesor forcimin e mëtejshëm institucional të ERRU. Gjatë vitit 2012 përbushja e këtij objekti është realizuar duke bashkëpunuar dhe mbështetur batimin e Metodologjisë së re të vendosjes së Tarifave, publikimin për herë të parë të Raportit të Performancës të shoqërive ujësjellës kanalizime; rikonceptimin e faqes zyrtare të ERRU-së si dhe në hartimin e Kodit të integritetit të këtij institucioni. Gjithashtu nën mbështetjen e GIZ janë zhvilluar një sërë workshopesh, konferencash, vizita studimore apo asistime me konsulencë në shumë drejtime të tjera në fushën rregullatore.
- ❖ *Bashkëpunimi i mëtejshëm me programin e UNDP për qeverisjen vendore për:*
 - Zhvillimin e studimit për perceptimin e qytetarëve mbi cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime;
 - Zhvillimin e studimit për Qasjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në zonat informale urbane dhe në zonat rurale në 5 rrethe të Shqipërisë
- ❖ *Bashkëpunimi me USAID* përmes programit të tij për qeverisjen vendore është zhvilluar faza e dytë e Trajnimit të Këshillave Mbikëqyrës si organi mbikëqyrës i shoqërive ujësjellës kanalizime nëpërmjet një manuali të përditësuar me zhvillimet e sektorit të ujit.
- ❖ *Bashkëpunimi me ADA (Agjensia Austriake për Zhvillim)* përmes së cilës u siguroi një mbështetje financiare për hartimin e një Kontrate model për Shitjen e Ujit me shumicë për të siguruar standarde dhe rregulla uniforme që ti përgjigjen zhvillimeve dhe rregullimit të marrëdhënies midis palëve që blejnë dhe shesin ujë me shumicë.

Bashkëpunimi i ERRU me Institucione Ndërkombëtare

❖ *ERRU – Rregullatorë Ndërkombëtar*

- Në kuadër të bashkëpunimit me rregullatorë të tjerë Ndërkombëtar, në Shtator të vitit 2012 ERRU nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Komisionin Rregullator të Ujit dhe Energjisë të Bullgarisë në Sofie të Bullgarisë. Qëllimi i kësaj marrëveshje është shkëmbimi i eksperiencave rregullatore midis dy vendeve si dhe bashkëpunimi në fushën e ujit. Në kuadër të këtyre

marrëveshjeve edhe për këtë vit 2012 ERRU dhe ZRRUK, Kosovë zhvilluan workshop-in e përvitshëm në qytetin e Sarandës. Çështjet kryesore të trajtuara gjatë këtij workshopi ishin në lidhje me standardet minimale të shërbimit, ndërprerjen ose jo të furnizimit me ujë dhe cilat janë praktikatat e secilit institucion, ankesat e konsumatorëve, kushtet e licencimit, procesi tarifar për ujin dhe kanalizimet, planet e biznesit të shoqërive.

❖ *ERRU – Institucione Ndërkombëtare në fushën e Ujit*

- ERRU si anëtar i IWA ka marrë pjesë në shume aktivitete të organizuara gjatë vitit 2012 siç kanë qënë *Konferenca Europiane* e shoqërive UK në Vienë, Austri; *Konferenca Botërore mbi Klimën, Ujin dhe Energjinë* në Dublin, Irlandë, si dhe Kongresi Botëror i Ujit i zhvilluar në Busan të Koresë së Jugut.
- ERRU ishte pjesëmarrëse në një nga eventet më të rëndësishëm në fushën e ujit siç është Java Botërore e Ujit e organizuar nga *Instituti Ndërkombëtar i Ujit në Stokholm* në fund të muajit gusht .
- ERRU ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Kursimi dhe Efiçenca e Energjisë në shoqëritë ujësjellës kanalizime” e organizuar nga *IEC, Crocus Expo* ne Moske te Rusisë. Gjatë kësaj konference u bë prezantimi i një punimi me titull “Përmirësimi i Efiçencës së Energjisë në impiantin e trajtimit të Ujërave të Ndotura në qytetin e Pogradecit – Rast Studimor”
- Gjatë vitit 2012 ERRU ka qënë gjithashtu pjesëmarrës në konferencën dhe panairin e organizuar *WQA Aquatech* në Las Vegas, USA në lidhje me “ Shfaqjen e mundësive për zhvillimin e teknologjive dhe standarteve të Ujit”. Fokusi i kësaj konference ishte rritja e mundësive për trajtimin e ujit të shoqëruar me pajisje të një teknologjie të lartë.

Marrëdhëniet e ERRU me Median

Mediat vizive dhe ajo e shkruar, gjatë vitit 2012 kanë treguar një interesim të veçantë për reflektimin e punës së ERRU-së. Komunikimi me mediat është realizuar nëpërmjet njoftimeve për shtyp , intervistave, pjesëmarrjes në programe të ndryshme televizive etj. Çështjet më kryesore që kanë ngjallur interesimin e mediave kane qënë ndryshimi i tarifave, cilësia e ujit dhe përmirësimi i shërbimit ndaj Konsumatorit. Komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun e gjerë ka sjell ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë jetike të këtij sektori por edhe në të njëjtën kohë ka përmirësuar transparencën e rregullatorit si një nga parimet bazë për të arritur vizionin e ERRU-së.


1.6 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU

Të ardhurat

Burimet e financimit të aktivitetit e veprimtarisë së ERRU, sikurse përcaktohet ne ligjin nr. 8102, date 28.03.1996 janë pagesat rregullatore, pagesat për liqensimet dhe donacionet. Në dy vitet e fundit, duke paraparë situatën financiare të operatorëve, KKRR ka vendosur pagesa rregullatore të cilat ne asnjë rast nuk e kalojnë nivelin një përqind të të ardhurave të parashikuara nga vetë operatorët ne aplikimet e tyre për ndryshimet e tarifave. Në të gjitha kontratat që Enti ka lidhur me operatorët për aplikimin e tarifave, ka përcaktuar pagesën rregullatore dhe afatet e likuidimit të tyre në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Gjatë këtij viti Enti është financuar nga projekti gjerman GIZ. Konkretisht janë financuar aktivitete në kuadrin e bashkëpunimit e shkëmbimit të eksperiencave me institucione të

huaja e ndërkombëtare, hartimi dhe botimi Kodit të Integritetit, botimi dhe shpërndarja e Raportit vjetor të performancës për vitin 2011. Të ardhurat e realizuar për vitin garantuan tërësisht mbështetjen financiare dhe mbulimin e shpenzimeve vjetore të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të Entit dhe përmbushjen e objektivave vjetore në funksion të misionit e vizionit të tij. Për vitin 2012, të ardhurat totale të realizuara nga burimet e financimit, janë 39,284,112 lekë, prej të cilave 37,684,596 lekë nga pagesat rregullatore, 1,050,000 lekë nga pagesat për liçensimet dhe 549,516 lekë si të ardhura të tjera. Në grafik paraqiten të ardhurat e realizuara për vitin 2012, në përqindje sipas strukturës së tyre.

Tabela 2 Të ardhurat



Megjithëse ERRU me të ardhurat e realizuara, ka mundur mbulimin e shpenzimeve vjetore të vitit, përqindja e arkëtimeve nga pagesat rregullatore për vitin 2012, krahasuar me vitin 2011 kanë rënë në masën 25.2 %. Aktualisht vetëm 14 përqind e operatorëve të kontraktuar kanë shlyer detyrimet kontraktuale, 40.5 përqind e tyre kanë detyrime të pashlyera për një periudhë mbi 2 vjet dhe 45.5 përqind kane detyrime të pashlyera për llogari të vitit 2012.

Shpenzimet operative

Enti në hartimin e planit vjetor të shpenzimeve, kushtëzohet nga mundësitë e tij për realizimin e të ardhurave. Realizimi i të ardhurave bëhet i vështirë për shkak të gjendjes ekonomike financiare të një pjese të mirë të shoqërive UK. Ndërkohë zgjerimi i aktivitetit dhe veprimtarisë së Entit në përmbushje të masave të përcaktuara në strategjinë sektoriale të sektorit UK, kërkon mbështetje financiare që reflektohet në rritjen e shpenzimeve vjetore të institucionit.

Për vitin 2012 plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU, është miratuar me VKM nr. 754, datë 02.11.2011, "Për miratimin e fondit të shpenzimeve, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për vitin 2012". Në total plani vjetor i shpenzimeve operative të Entit për vitin 2012 është në shumën 36.345.000 leke dhe i detajuar në zëra si më poshtë:

Tabela 3 Plan i shpenzimeve




Realizimi i shpenzimeve

Gjatë këtij viti shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit e veprimtarisë vjetore të Entit janë në shumën 34 610 076 lekë, ose 95.22 % të fondit të planifikuar.

Nga këto:

- 20 239 612 leke, shpenzime për pagat e punonjësve.
- 2 671 242 leke, shpenzime për sigurime shoqërore të punonjësve.
- 9 162 361 leke, shpenzime të kryera për shërbime e furniturë.
- 2 536 860 leke, shpenzime për investime.

Grafiku 4 Realizimi i shpenzimeve



Përdorimi i fondeve të planifikuara, është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi si për trajtimin me paga e shpërblime të të punësuarve ashtu dhe për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike”. Po kështu është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për mallrat dhe shërbimet e ndryshme duke kryer njëkohësisht edhe pagesat përkatëse.

Fondi i pagave e shpërblimeve është realizuar në masën 92.54 përqind të fondit të planifikuar. Fondi i planifikuar në zërin sigurime shoqërore është realizuar në masën 97.85 përqind, diferenca në këta dy zëra është si rezultat i mosplotësimit të një funksioni në organike. Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 99.6 përqind. Me këto fonde, në përputhje me detajimin e bërë nga Komisioni Kombëtar, gjatë vitit janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës si dhe një bazë materiale e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të Komisionit dhe gjithë stafit punonjës. Fondet e planifikuara në zërin investime janë shpenzuar në masën 99.68 përqind.

2. Gjendja në sektorin Ujësjellës Kanalizime

Performanca e shërbimit në sektorin UK

Aktualisht shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime e kryejnë 57 operatorë ujësjellës - kanalizime. Ofrimi i shërbimit nga operatorë të licencuar dhe me një tarifë të miratuar nga ERRU është i rëndësishëm pasi garanton konsumatorët që shërbimi u ofrohet nga operatorë të kualifikuar dhe se ata paguajnë tarifa të drejta. Popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga këta operatorë jeton kryesisht në zonat urbane. Konkretisht, operatorët mbulojnë me shërbimin e furnizimit me ujë rreth 80% të popullsisë në zonën e juridiksionit.

Në përgjithësi çdo operator në Shqipëri e siguron furnizimin me ujë nga dy ose me shumë sisteme, të cilat mund të jenë me rrjedhje të lirë, me ngritje mekanike ose të kombinuar. Rreth 80% e ujit të prodhuar realizohet me sistemet me ngritje mekanike dhe vetëm 20% prodhohet nga sistemet me rrjedhje të lirë. Shërbimi i kanalizimeve vazhdon të mbetet prapa atij të furnizimit me ujë në shumë aspekte. Ky shërbim i ofrohet vetëm 50% të popullsisë në zonën e juridiksionit dhe kjo në pjesën më të madhe në zonat urbane. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar shërbimin e largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për një pjesë të madhe të vendit, si për sa i përket mbulimit po ashtu edhe nivelit të kërkuar të shërbimit për të mundësuar mbrojtjen e ujërave dhe të mjedisit. Vetëm 31 shoqëri ofrojnë shërbimin e largimit të ujërave të ndotura dhe janë në funksion vetëm tre impiante të trajtimit të ujërave të ndotura në vend.

Cilësia e shërbimit të furnizimit me ujë

ERRU ka vlerësuar performancën e operatorëve në lidhje me kohëzgjatjen e furnizimit me ujë të konsumatorëve mbi bazën e analizës dhe monitorimit të treguesve kryesor të performancës dhe mbi këtë bazë bën vlerësimin e situatës të sektorit ujësjellës kanalizimeve në tërësi. Në metodologjinë e vendosjes së tarifave, ERRU i ka kushtuar një vëmendje të veçantë si performancës aktuale të operatorëve të cilët aplikojnë për ndryshim tarifash, por edhe objektivave që duhet të arrijnë këta operatorë me tarifat që u miratohen nga KKRR. Që në vitin e parë të funksionimit të kësaj metodologjie (viti 2012), operatorëve të cilët kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave u janë caktuar objektivat e performancës që duhet të arrijnë gjatë vitit të ardhshëm. Ndryshimi i tarifave në vitet më pas do të jetë i kushtëzuar me arritjen e këtyre objektivave. ERRU do të stimulojë dhe mbështesë përpjekjet e operatorëve për të përmirësuar shërbimet ndaj klientëve të tyre, por nga ana tjetër kërkon që vetë operatorët të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rritur efikasitetin operacionale.

Kohëzgjatja e furnizimit me ujë të konsumatorëve vazhdon të mbetet në nivele jo të mira gjë që reflektohet në mos furnizimin e vazhdueshëm të klientëve me ujë të pijshëm dhe me presionin e duhur. Duke iu referuar të dhënave të Njësisë së Monitorimit dhe Benchmarking, DPUK, shkalla e furnizimit me ujë varion nga 4 - 24 orë ujë në ditë edhe gjatë vitit 2012. Kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë në vitin 2011 ka qenë 11.4 orë në ditë, kurse për vitin 2012 është 10.72 orë në ditë. Pra si sektor ka një ulje të orëve mesatare të furnizimit me ujë edhe pse ka operatorë që këtë tregues e kanë përmirësuar. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm me ujë vjen edhe si rezultat i ndërprerjeve për shkaqe teknike dhe si pasojë amortizimit të rrjetit të shpërndarjes gjë e cila ndikon në cilësinë e ujit për konsum publik.

Instituti i Shëndetit Publik dhe Drejtoritë Rajonale të shëndetit Publik bëjnë kontrollin dhe monitorimin e përditshëm të të dhënave të cilësisë së ujit për konsum publik, kryesisht në zonat urbane të vendit, por edhe vetë operatorët bëjnë kujdes për trajtimin e ujit të pijshëm. ERRU duke pasur parasysh mandatin e tij për mbrojtjen e konsumatorit edhe pse nuk është institucioni drejtpërdrejtë përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit, garantimi i furnizimit me ujë "te pastër" përbën prioritet kryesor. ERRU sëbashku me ISHP dhe DRSH në rrethe do të forcojë bashkëpunimin në mënyrë që konsumatorët do të mund të përdorin ujin e pijshëm të rrjetit vetëm kur standardet e sigurisë të përmbushen në mënyrë të qëndrueshme.


Uji pa të ardhura

Uji pa të ardhura përfaqëson diferencën ndërmjet volumit të ujit të prodhuar dhe atij të faturuar. Në gjuhën ekonomike përfaqëson sasinë e ujit që nuk sjell të ardhura (humbjet), dhe është i lidhur me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Uji i prodhuar nga të 57 operatorët UK gjatë vitit 2012 ka qënë 282,424,000 m³ për 2.59 milion banorët që furnizohen nga këta operatorë. Duke patur parasysh normat e caktuara të furnizimit me ujë si dhe kërkesat e klientëve privat dhe institucional, kjo sasi uji (298 l/frymë /ditë) përballon kërkesat normale për ujë të të gjithë klientëve të mësipërm. Problemi kryesor janë nivelet e larta të humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë të cilat sjellin furnizim me orar dhe gjendje financiare të dobët të operatorëve. Edhe gjatë vitit 2012 niveli i humbjeve vazhdon të mbetet i lartë dhe konkretisht llogaritet në 62% nga 63% që ishte në vitin 2011. Kjo ulje me 1% është shumë pak në krahasim me atë ku duhet të arrijë sektori duke kërcënuar qëndrueshmërinë financiare të shume prej shoqërive.

Në Strategjinë Kombëtare të sektorit ujësjellës kanalizime, niveli i ujit pa të ardhura në vitin 2012 duhet të arrijë nivelin prej 57%. Lidhur me këtë tregues ka operatorë të cilët kanë punuar mirë në drejtim të reduktimit të humbjeve, por ka dhe operatorë që qëndrojnë në të njëjtin nivel ose në përkeqësim të situatës. Me përjashtim të humbjeve teknike të lejuara që vijnë si rezultat i mënyrës së funksionit të sistemit, pjesa tjetër e humbjeve vjen nga amortizimi i rrjetit shpërndarës si dhe nga keqmenaxhimi nga vetë operatorët lidhur me identifikimin dhe ndërprerjen e lidhjeve të paligjshme dhe vendosjen e matësve të ujit.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve. Operatorët duhet të kenë plane të qarta veprimi për të përkrahur angazhimeve konkrete për reduktimin e humbjeve të ujit.

Grafiku 5 Uji pa të ardhura në %



Niveli i matjes

Konsumatori duhet të paguajë për atë që konsumon, dhe një gjë e tillë arrihet kur çdo konsumator të jetë pajisur me matës të ujit. Si sektor për vitin 2012 nga 606,870 klientë, vetëm 55 përqind e tyre kanë të instaluar matësat, pjesa tjetër faturohet aforfe. Operatorët kanë patur detyrim që deri në fund të vitit 2010 të kishin instaluar matësat në të gjithë klientët jo familjarë dhe objektivi për të ardhmen është që të pajisen me matës dhe klientë familjarë. Por kjo ende nuk është realizuar pasi në nivel sektori ende 14,914 klientë jo familjarë nga 57,500 që janë gjithsej nuk janë të pajisur me matës. ERRU vazhdimisht gjatë vitit 2012 ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësve.

Sasia e ujit të matur të faturuar për vitin 2012 zë 59% të totalit të faturuar, dhe mbetet në të njëjtin nivel me atë të vitit paraardhës. Një faktor tjetër që ndikon në uljen e sasisë së ujit të matur të faturuar është ndryshimi i tarifave, konsumatorët paguajnë tarifa më të larta krahasuar me vitet e mëparshme dhe kjo bën që ata të mundohen ta kursejnë ujin që konsumojë.

Praktika tregon që konsumi mesatar ditor i matur është më i ulët se norma 150litra/ditë/klient e përdorur për faturimin aforfe. Lidhja e kontratës model me konsumatorët ka bërë që të rritet kërkesa e konsumatorëve për tu pajisur me matësa. Gjatë vitit 2012, në fund të nëntë mujorit rezultoi të jenë instaluar 33,500 matësa.


Tabela 4 Tendenca e faturimit të matur në vite

Vitet	Totali i Faturimit m ³	Faturimi i matur m ³	Faturimi i matur %	Trendi
2008	86,089	34,265	40	↗
2009	90,640	37,607	41	↗
2010	122,501	54,967	45	↗
2011	108,400	64,273	59	↗
2012	105,934	62,613	59	=

Norma e arkëtimit

Duke iu referuar të dhënave të Njesisë së Monitorimit për vitin 2012, rezultoi se niveli mesatar i normës së arkëtimit për sektorin është 88%. Ky tregues ka një përmirësim me 8% i krahasuar me vitin 2011. Të dhënat tregojnë se për disa operatorë niveli i këtij treguesi është mbi 90% por ka dhe operatorë me normë të ulët arkëtimi që arrijnë deri në 60%. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtij treguesi lidhet drejtpërdrejt me aftësinë paguese të operatorit, pra me situatën financiare të tij. Sipas strategjisë sektoriale ky tregues duhet të rritet me 2% në vit me qëllim që në vitin 2017 të arrijë nivelin 98%. Duke parë ecurinë e këtij treguesi objektivi i caktuar është plotësisht i mundshëm për tu realizuar. Ky është një tregues menaxherial që varet drejtpërdrejt nga puna e vetë operatorëve.

Grafiku 6 Numri i shoqërive sipas normës së arkëtimit¹




Mbulimi i Kostos Operative dhe Kostos Totale

Treguesi "Mbulimi i Kostove O&M" shpreh se deri në çfarë mase kostot e drejtpërdrejta O&M (pa amortizimin) mbulohen me të ardhurat nga aktiviteti. Ky është një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie. Në vitin 2012, në shkallë sektori, ky tregues është në nivelin 98%, duke i paraprirë përbushjes në këtë mënyrë të njërit prej objektivave të Strategjisë Sektoriale që në vitin 2013 mbulimi i kostove O&M me të ardhurat e realizuara të jetë në masën 100%.

¹ Mungojnë të dhënat për dy operatorë

Për ERRU, mbulimi kostove O&M përbën objektivin aktual si hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Vendimet e mara nga ERRU lidhur me ndryshimet e tarifave për 14 operatorë të cilët operuan me këto tarifa gjatë vitit 2012, kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave, dhe për rrjedhojë edhe në mbulimin e kostove O&M. Jo vetëm rritja e të ardhurave por edhe mbajtja vazhdimisht nën kontroll e kostove është po aq e rëndësishme për nivelin e këtij treguesi. Nga të dhënat rezultojnë se 13 operatorë mbulojnë kostot e operim mirëmbajtjes mbi 100%.


Grafiku 7 Mbulimi kostove me të ardhura



Objektivi kryesor i çdo shoqërie nga pikëpamja financiare është mbulimi i kostove totale (kostot operim dhe mirëmbajtje plus amortizimin dhe kostot kapitale, d.m.th. interesi/shlyerja e huave) me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e saj kryesore dhe nga shërbimet e tjera. Bazuar në strategjinë e qeverisë për sektorin ujësjellës kanalizime ky objektivi do të arrihet gradualisht, duke filluar së pari me mbulimin e kostove operative dhe ato të mirëmbajtjes (O&M). Në vitin 2012, mesatarja për mbulimin e kostos totale për sektorin është 76% nga 74% që ishte në vitin 2011. Edhe për sa i përket këtij treguesi 6 operatorë në vitin 2012 kanë mbuluar kostot totale mbi 100%, pra rezultojnë me fitim dhe synimi i tyre është riciklimi i fitimit në investime në sistemin e ujësjellës kanalizimeve. Por ka ende operatorë, kryesisht operatorë të vegjël, që me të ardhurat e tyre nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë.

Përmirësimi i situatës financiare të sektorit është kompleks. Ajo nuk mund të vijë vetëm nga influenca e ndryshimit të tarifave por edhe nga përmirësimi i treguesve të punës dhe i mbajtjes nën kontroll të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve.

Grafiku 8 Struktura e shpenzimeve



Peshën specifike më të madhe në totalin e shpenzimeve e zënë kostot e personelit, të energjisë elektrike dhe amortizimi. Përgjithësisht operatorët UK kanë numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 9,3 punonjës/1000 lidhje. Për një numër të vogël operatorësh niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje është 4-5 punonjës. Përmirësimi i efikasitetit të stafit do të ndikojë në nivelin e shpenzimeve për këtë zë. Operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, kostoja e energjisë elektrike zë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. Shpenzimet për energjinë elektrike janë rritur edhe për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos për ata operatorë që administrojnë edhe impiantet e trajtimit.

Reduktimi i humbjeve nëpërmjet menaxhimit të mirë të operatorit si dhe ndërprerja e lidhjeve të paligjshme dhe vendosja e matësave detyrimisht do të sjellë uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë uljen e kostos së energjisë elektrike. Operatorët duhet të punojnë në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të energjisë i cili është një indikator mjaft i rëndësishëm me impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës financiare të operatorëve. Edhe për vitin 2012 në përgjithësi janë ruajtur po ato nivele të shprehura në përqindje të zërave të kostos ndaj totalit si në vitin 2011. Burimi kryesor i të ardhurave për operatorët janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët. Gjatë këtij viti sektori ka gjeneruar rreth 6% më shumë të ardhura krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga ndryshimi i tarifave pasi niveli i faturimit është ulur me 2.4%.

Edhe gjatë vitit 2012 qeveria ka akorduar subvencione por krahasuar me vitin e mëparshëm ka ulje të tyre. Ky është një sinjal që operatorët duhet të sigurojnë pavarësinë ekonomike dhe të realizojnë të ardhurat për përballimin vetë të shpenzimeve. Në sektorin ujësjellës kanalizime janë kryer dhe po vazhdojnë të kryhen investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve apo ndërtimin e sistemeve të reja. Një vend të rëndësishëm zënë investimet për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Burimi kryesor i investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit, si dhe kreditë dhe grantet nga donatorët e huaj. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2012 disa operatorë kanë përdorur edhe burimet e tyre financiare për të kryer investime kryesisht për rikonstrukcione apo zgjerimin e zonës së tyre të shërbimit.

Pronësia dhe kontrolli i ujësjellësve

Në bazë të VKM nr. 660 datë 12.09.2007 “ Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve në njësi të qeverisjes vendore”, brenda vitit 2009, të gjitha asetet e sistemeve ujësjellës kanalizime duhet të kalonin në pronësi të pushteteve vendore. Ky proces rezultoi të ishte i gjatë dhe ende i papërfunduar për disa shoqëri edhe në vitin 2012. Aktualisht nga 57 shoqëri ujësjellës kanalizime që operojnë në sektor, pjesa më e madhe e tyre kanë kaluar në pronësinë e pushtetit vendor. Shoqëri si Durrësi, Elber sh.p.k, Gjirokastër Fshat, Mirditë, Rubik, Lezhë nuk e kanë përfunduar ende procesin e transferimit të aseteve.

Sektori i shërbimeve UK funksionon nëpërmjet shoqërive aksionare me pronar pushtetin vendor. Pas procesit të decentralizimit ndodhen ndryshime të rëndësishme në sektor, ku mund të përmendim bashkimin e dy shoqërive ujësjellës kanalizime, atë të Beratit dhe Kuçovës në shoqërinë Ujësjellës Kanalizime sh.a. Berat – Kuçovë nëpërmjet ndihmës së projektit të KFW. Këto ndryshime vazhduan edhe në vitin 2012, ku Bashkia Himarë i tërhoqi aksionet nga shoqëria sh.a. Ujësjellës Vlore dhe krijoi shoqërinë e 57 në sektor, Ujësjellës sh.a. Himarë.

3. Këndvështrimi për vitin 2013

Viti 2013 do të jetë një vit tjetër progresi për ERRU në drejtim të një performance gjithnjë në rritje në ushtrimin e të funksionit të tij dhe në zbatimin e mandatit dhe misionit rregullator. ERRU do të vazhdojë të ndërmarrë iniciativa, që do të fokusohen në arritjen e objektivave të tij. Për vitin e ardhshëm janë parashikuar aktivitetet e mëposhtme:

- ❖ Të vazhdojë procesi i liçencimit të të gjithë ofruesve të shërbimit që operojnë në sektorin UK nëpërmjet;
 - Përmirësimi i legjislacionit në fuqi në përputhje me zhvillimet aktuale të sektorit;
 - Hartimit të rregulloreve përkatëse për të ushtruar proceset rregullatore veçanërisht në zona jashtë mbulimit nga shoqëritë e licencuara.
- ❖ Të vazhdojë zbatimin e Metodologjisë së Vendosijes së Tarifave në mënyrë objektive dhe transparente nëpërmjet:
 - Hartimit të një Udhëzuesi mbi paraqitjen e aplikimit bazuar në Planin e Biznesit sipas rregullatorit;
 - Hartimit të një Udhëzuesi mbi zbatimin e metodologjisë për operatorët që administrojnë sisteme të vogla;
 - Hartimi i një udhëzimi për kontabilitetin e kostos;
 - Kontrolli i zbatimit të tarifave të miratuara nga ERRU.
- ❖ Të trajtojë me prioritet çështjen e mbrojtjes së konsumatorëve me aktivitetet e mëposhtme:
 - Përgatitjen e një manuali standard për shërbimin e kujdesit ndaj klientit për të gjithë operatorët UK;
 - Përgatitjen e një manuali për menaxhimin e ankesave nga ana e ERRU;
 - Përgatitjen e një manuali për zhvillimin e seancave dëgjimore;
 - Të zhvillojë më tej aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit të operatorëve UK lidhur me çështjet e konsumatorëve;
- ❖ Të vijojë zbatimin e Planit të Veprimit për aplikimin në rang kombëtar të Kontratës së Konsumatorit;
- ❖ Të krijojë dhe të garantojë zbatimin e standardeve të punës dhe të inkurajojë standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin;
- ❖ Të zhvillojë në partneritet standarte për efikasitetin e energjisë në sektorin UK;
- ❖ Të vijojë mbështetjen e procesit të zbatimit të Strategjisë së Sektorit UK në përgjithësi dhe veçanërisht në fushat ku ERRU është identifikuar si institucion udhëheqës;
- ❖ Të vazhdojë të konsolidojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët në sektorin UK;
- ❖ Pjesëmarrja aktive në grupin e punës për ndryshimet në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

4. Rekomandime për sektorin UK

- ❖ Rishikimi i çështjes së ofrimit të shërbimit UK, dhe gjetja e zgjidhjeve të mundshme në lidhje me :
 - Mbulimin me shërbime UK nga operatori në të gjithë zonën e juridiksionit;
 - Kërkesën e disa NjQV për ta ofruar vetë shërbimin UK , duke u shkëputur nga operatori;
 - Ofrimin e shërbimit UK të licencuar nga NjQV jashtë zonës së juridiksionit të operatorëve;
- ❖ Nëpërmjet një procesi të qëndrueshëm monitorimi të shtohen nxitjet për të rritur eficientë e shoqërive UK duke përmirësuar treguesit e performancës.
- ❖ Rritja e rolit të qeverisjes vendore dhe përfshirja e saj në proceset reformuese të sektorit.
- ❖ Këshillat Mbikëqyrës duhet të vazhdojnë rritjen e rolit dhe përgjegjësisë së tyre si autoriteti qeverisës i operatorëve UK, siç parashikohet në legjislacionin përkatës.
- ❖ Operatorët UK duhet vënë në fokus të punës së tyre treguesin e eficientë së energjisë për përmirësimin e kostove të shërbimit.
- ❖ Operatorët UK duhet të punojnë për përmirësimin e punës së tyre me fokus në marrëdhënien me konsumatorët.
- ❖ Të gjithë operatorët UK duhet të vazhdojnë implementimin e kontratës model midis operatorit dhe klientit, proces i cili duhet të jetë transparent dhe i monitoruar nga ERRU;
- ❖ Operatorët UK duhet të përfundojnë instalimin e ujëmatësve për klientët jo-familjarë, gjithashtu të vazhdojnë me ritme të shpejta instalimit i ujëmatësve për konsumatorët familjarë.
- ❖ Shpërndarja e investimeve duhet të jetë e lidhur ngushtë edhe me përmirësimin e indikatorëve të performancës.
- ❖ Rishikimi i skemës së subvencioneve, që është iniciuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, duhet të vazhdojë dhe të finalizohet në bashkëpunim të ngushtë me ERRU, Ministrinë e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe përfshirjen në planin e shpërndarjes së tyre.
- ❖ Sistemi kombëtar i monitorimit të cilësisë së ujit duhet të zhvillohet më tej në mënyrë që analizat e cilësisë së ujit dhe procedurat e raportimit të jenë në përputhje me praktikatat më të mira.
- ❖ Së fundmi, suksesi i reformimit dhe zhvillimit të sektorit shqiptar UK do të varet edhe nga bashkëpunimi i hapur ndërmjet institucioneve të përfshira.

